



Në bazë të nenit 35, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, nenit 65 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77 / 16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 10 / 03 prill 2017, Prishtinë) dhe në bazë të nenit 8, paragrafit 4 si dhe nenit 136 të Ligjit nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 / 14 maj 2026), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2026, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË SHUMËS MINIMALE MONETARE TË SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISË PROFESIONALE OSE GARANCIVE TË TJERA TË NGJASHME

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore përcakton kriteret dhe treguesit për shumën minimale monetare të sigurimit të përgjegjësisë ose garancive të tjera të ngjashme, si dhe formulën e llogaritjes së tyre, për përcaktimin e shumës minimale monetare të sigurimit të përgjegjësisë profesionale- SPP-së ose garancive të tjera sipas paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 8 të Ligjit nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave, të zbatueshme për subjektet që aplikojnë për autorizim si ofrues të shërbimit të inicimit të pagesës ose regjistrim si ofrues të shërbimit të informacionit të llogarisë.

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo rregullore zbatohet për aplikuesit për autorizim si institucion pagese ose për regjistrim si ofrues i shërbimeve të informacionit të llogarisë pranë Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), për të ofruar shërbimet e inicimit të pagesave dhe shërbimet e informacionit të llogarisë, siç përcaktohet në nenin 4, paragrafi 1 nënparagrafët 1.14 dhe 1.15 të Ligjit nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave.
2. Rishikimi vjetor i parashikuar në nenin 14 të kësaj rregullore është i zbatueshëm për subjektet tashmë të licencuara ose të regjistruara për të ofruar shërbime të inicimit të pagesave dhe shërbime të informacionit të llogarisë.

Neni 3

Përkufizimet

1. Termat dhe përkufizimet e përdorura në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim si në nenin 4 të Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave.
2. Krahës paragrafit 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat dhe shkurtesat e mëposhtme kanë këtë kuptim:
 - 2.1. **“SHILL”** nënkupton shërbimet e informacionit të llogarisë siç përcaktohet në Ligjin për Shërbimet e Pagesave;
 - 2.2. **“OSHILL”** nënkupton një ofrues shërbimesh të informacionit të llogarisë siç përcaktohet në Ligjin për Shërbimet e Pagesave;
 - 2.3. **“OSHPLL”** nënkupton një ofrues të shërbimeve të pagesave të llogarisë siç përcaktohet në Ligjin për Shërbimet e Pagesave;
 - 2.4. **“BQK”** nënkupton Bankën Qendrore të Kosovës;
 - 2.5. **“Subjekt”** nënkupton:
 - 2.5.1 një ndërmarrje që aplikon për licencë për ofrimin e shërbimeve të inicimit të pagesave;
 - 2.5.2 një ndërmarrje që aplikon për regjistrim për ofrimin e shërbimeve të informacionit të llogarisë;
 - 2.5.3 një ndërmarrje që aplikon për licencë për ofrimin e shërbimeve të inicimit të pagesave dhe shërbimeve të informacionit të llogarisë;
 - 2.5.4 ose ndonjë nga ndërmarrjet e përmendura në nënparagrafët e mëparshëm tashmë të licencuara ose të regjistruara, sipas rastit, siç parashikohet në paragrafin 2 të nenit 2 të kësaj rregullore.
 - 2.6. **“Ligji për Shërbimet e Pagesave” ose “LSHP”** nënkupton Ligjin nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave;
 - 2.7. **“IP”** nënkupton një institucion pagesash siç përcaktohet në Ligjin për Shërbimet e Pagesave;
 - 2.8. **“OSHIP”** nënkupton një ofrues shërbimesh të inicimit të pagesave siç përcaktohet në Ligjin për Shërbimet e Pagesave;
 - 2.9. **“SPP”** nënkupton sigurimin e përgjegjësisë profesionale siç përcaktohet në Ligjin për Shërbimet e Pagesave;
 - 2.10. **“SHIP”** nënkupton shërbimet e inicimit të pagesave siç përcaktohet në Ligjin për Shërbimet e Pagesave.

KAPITULLI II

KRITERET PËR SHUMËN MINIMALE MONETARE TË SIGURIMIT TË PËRGJEGJËSISË OSE GARANCIVE TË TJERA TË NGJASHME

Neni 4

Qëllimi dhe fushëveprimi

Ky kapitull përcakton kriteret dhe treguesit për shumën minimale monetare të sigurimit të përgjegjësishë ose garancive të tjera të ngjashme, si dhe formulën e llogaritjes së tyre, për përcaktimin e shumës minimale monetare të SPP-së ose garancive të tjera të ngjashme që duhet të mbahen nga subjektet që i nënshtrohen kësaj rregullore, për subjektet dhe personat e përcaktuar në nenin 2 të kësaj rregullore.

Neni 5

Sigurimi i përgjegjësishë profesionale dhe garancitë e ngjashme

1. Për qëllime të kësaj rregulloreje, SPP dhe garancitë e ngjashme konsiderohen si ekskluzive në mënyrë reciproke dhe BQK u kërkon subjekteve që të mbajnë SPP ose garanci të tjera të ngjashme në çdo rast.
2. SPP-ja ose garancitë e tjera të ngjashme të mbajtura nga subjektet për qëllimet e nenit 8, paragrafët 2 dhe 3 të LSHP-së mbulojnë detyrimet e tyre si më poshtë:
 - 2.1. në rastin e subjekteve që aplikojnë për licencë për ofrimin e SHIP, detyrimet e përcaktuara në nenet 73, 89, 90 dhe 92 të LSHP-së;
 - 2.2. në rastin e subjekteve që aplikojnë për regjistrim për të ofruar SHILL, detyrimet kundrejt OSHPLL-së ose përdoruesve të shërbimit të pagesave që rrjedhin nga përdorimi i paautorizuar ose mashtrues i informacionit të llogarisë së pagesave;
 - 2.3. në rastin e subjekteve që aplikojnë për licencim për të ofruar SHIP dhe SHILL, detyrimet e përmendura në nënparagrafët 2.1 dhe 2.2 të këtij neni.
3. Shuma minimale monetare e SPP-së ose garancive të ngjashme do t'i mbulojë gjithashtu kostot e shkaktuara nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave dhe OSHPLL-të në lidhje me kërkesat për rimbursimin e humbjeve që rezultojnë nga një ose më shumë nga detyrimet e përmendura në nenin 8, paragrafët 2 dhe 3 të LSHP-së.
4. Shuma minimale monetare e SPP ose garancive të ngjashme i mundëson subjekteve t'i përmbushin në mënyrë efektive detyrimet e tyre në lidhje me aktivitetet e tyre duke verifikuar që SPP ose garancitë e ngjashme nuk përmbajnë ndonjë klauzolë që mund t'i paragjykojë ripagesat që rezultojnë nga kërkesat për rimbursim nga përdoruesit e shërbimeve të pagesave dhe OSHPLL-të dhe se ato janë të vlefshme dhe të zbatueshme kur lind detyrimi.
5. Shuma minimale monetare e SPP ose garancia e ngjashme mbulon territoret në të cilat subjekti ofron shërbime, pavarësisht nga vendet ku janë të vendosur përdoruesit e tyre ose nga vendi në të cilin ofrohen shërbimet.

Neni 6

Kriteret dhe treguesit e sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garancive të ngjashme

1. Kriteret e mëposhtme përdoren për ta llogaritur shumën minimale monetare të SPP ose garancive të ngjashme të parashikuara në nenin 5 të kësaj rregullore:
 - 1.1. kriteri i profilit të rrezikut, bazuar në treguesit e mëposhtëm:
 - 1.1.1 vlera e kërkesave për rimbursime të pranuar nga subjekti për detyrimet e përmendura në nenin 8, paragrafët 2 dhe 3 të LSHP-së;
 - 1.1.2 numri i transaksioneve të pagesave të iniciuara nga një subjekt që ofron SHIP;
 - 1.1.3 numri i llogarive të pagesave të qasura nga një subjekt që ofron SHILL;
 - 1.2. kriteri i llojit të aktivitetit, bazuar në treguesit e mëposhtëm:
 - 1.2.1 nëse subjekti ofron ekskluzivisht SHIP ose SHILL, ose të dyja;
 - 1.2.2 nëse subjekti ofron shërbime të tjera pagesash siç përmendet në nenin 4, nënparagrafi 1.2 i LSHP-së;
 - 1.2.3 nëse subjekti është i angazhuar në aktivitete biznesi të ndryshme nga shërbimet e pagesave siç parashikohet në nenin 20 të LSHP-së;
 - 1.3. kriteri i madhësisë së aktivitetit, bazuar në treguesit e mëposhtëm:
 - 1.3.1 për subjektet që ofrojnë SHIP, vlera e transaksioneve të iniciuara;
 - 1.3.2 për subjektet që ofrojnë SHILL, numri i përdoruesve që përdorin SHILL;
 - 1.4. kriteri i garancive të ngjashme, bazuar në:
 - 1.4.1 karakteristikat specifike të garancive të ngjashme;
 - 1.4.2 nxitësit për ekzekutimin dhe zbatimin e garancive të ngjashme.

Neni 7

Llogaritja e shumës minimale monetare të sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garancive të ngjashme

1. Subjektet do ta llogarisin shumën minimale monetare të SPP ose garancive të ngjashme duke përdorur formulën e mëposhtme:

$$\begin{aligned} & \text{Shuma minimale monetare e SPP ose garancive të ngjashme} \\ & = \\ & \text{Shuma që pasqyron kriterin e profilit të rrezikut} \\ & + \\ & \text{Shuma që pasqyron kriterin e llojit të aktivitetit} \\ & + \\ & \text{Shuma që pasqyron kriterin e madhësisë së aktivitetit} \end{aligned}$$

2. Për ta llogaritur shumën minimale monetare të SPP ose garancive të ngjashme, subjekti duhet t'i plotësojë treguesit sipas secilit kriter me vlerat përkatëse të përcaktuara në nenet 8 deri në 12 të

kësaj rregulloreje dhe ta llogarisë shumën që pasqyron secilin kriter veçmas duke shtuar shumat që pasqyrojnë treguesit përkatës dhe duke përdorur shumat që rezultojnë në formulën e mësipërme.

3. Vlera minimale monetare e SPP ose garancive të ngjashme duhet të llogaritet nga subjektet që aplikojnë për licencë ose regjistrim për të ofruar SHIP ose SHILL, si dhe nga subjektet tashmë të licencuara ose të regjistruara për të ofruar SHIP ose SHILL, sipas kërkesave të raportimit periodik të nenit 14 të kësaj rregulloreje.

Nënkapitulli I

Llogaritja e shumës që pasqyron kriterin e profilit të rrezikut

Neni 8

Vlera e kërkesave për rimbursime të marra nga subjektet

1. Në llogaritjen e vlerës së treguesit "kërkesat e marra për rimbursim", subjektet duhet ta përdorin vlerën e përmbledhur të të gjitha kërkesave të rimbursimit të bëra nga përdoruesit e shërbimit të pagesave të subjektit dhe nga OSHPLL-të në 12 muajt e mëparshëm kalendarikë për humbjet që vijnë nga një ose më shumë nga detyrimet e përmendura në nenin 8, paragrafët 2 dhe 3 të LSHP-së.
2. Nëse subjekti nuk ka marrë asnjë kërkesë për rimbursim në 12 muajt e fundit, vlera për këtë tregues duhet të vendoset në 0 në formulë.
3. Për subjektet që nuk kanë ofruar shërbime pagese në asnjë moment gjatë 12 muajve të mëparshëm, duhet të përdoret vlera e përmbledhur e të gjitha kërkesave për rimbursim të parashikuara nga subjekti për qëllimin e aplikimit të tij për licencim ose regjistrim, sipas rastit.
4. Për subjektet në vitin e tyre të parë të aktivitetit në bazë të marrjes së licencës ose regjistrimit që nuk kanë përfunduar ende 1 vit të plotë kalendarik aktiviteti, duhet të përdoret vlera e përmbledhur e të gjitha kërkesave për rimbursim të parashikuara për qëllime të aplikimit për licencë ose regjistrim, sipas rastit.
5. Nëse subjekti nuk ofron asnjë parashikim të kërkesave për rimbursim, ose nëse shuma që rezulton nga aplikimi i vlerës totale të parashikuar të kërkesës për rimbursim është më e vogël se 50 000 (pesëdhjetë mijë) euro, vlera e këtij treguesi në formulë duhet të vendoset në 50 000 (pesëdhjetë mijë).

Neni 9

Numri i transaksioneve të pagesave të iniciuara nga subjektet që ofrojnë shërbime të inicimit të pagesave

1. Subjektet duhet ta llogarisin vlerën e treguesit "numri i transaksioneve të pagesave të iniciuara" si shuma e elementeve të mëposhtme:
 - 1.1. 40% e pjesës së N deri në 10 000 pagesa të iniciuara; plus
 - 1.2. 25% e pjesës së N mbi 10 000 deri në 100 000 pagesa të iniciuara; plus
 - 1.3. 10% e pjesës së N mbi 100 000 deri në 1 milion pagesa të iniciuara; plus

- 1.4. 5% e pjesës së N mbi 1 milion deri në 10 milionë pagesa të iniciuara; plus
- 1.5. 0.025% e pjesës së N mbi 10 milionë pagesa të iniciuara,
ku N është numri i transaksioneve të pagesave të iniciuara nga subjekti në 12 muajt e mëparshëm.
2. Për subjektet që nuk kanë ofruar shërbime pagese në asnjë moment gjatë 12 muajve të fundit, numri i transaksioneve të pagesave të iniciuara duhet të jetë numri i transaksioneve të pagesave të iniciuara të parashikuara nga subjekti për qëllimin e aplikimit të tij për licencë.
3. Për subjektet në vitin e parë të aktivitetit të tyre (pas marrjes së licencës), të cilat nuk kanë përfunduar 1 vit të plotë kalendarik aktiviteti, numri i transaksioneve të pagesave të iniciuara duhet të bazohet në numrin e transaksioneve të pagesave të parashikuara nga subjekti për qëllimin e aplikimit të tij për licencë.
4. Nëse subjekti nuk ofron asnjë parashikim në lidhje me numrin e transaksioneve të pagesave të iniciuara, ose nëse shuma që rezulton nga aplikimi i numrit të parashikuar të transaksioneve të pagesave të iniciuara është më e vogël se 50 000 (pesëdhjetë mijë), vlera për këtë tregues në formulë duhet të vendoset në 50 000 (pesëdhjetë mijë).

Neni 10

Numri i llogarive të pagesave të qasura nga subjektet që ofrojnë shërbimin e informacionit të llogarisë

1. Subjektet duhet ta llogarisin vlerën e treguesit “numri i llogarive të pagesave të qasura”, si shumë e elementeve të mëposhtme:
 - 1.1. 40% e pjesës së N deri në 10 000 llogari të qasura; plus
 - 1.2. 25% e pjesës së N mbi 10 000 deri në 100 000 llogari të qasura; plus
 - 1.3. 10% e pjesës së N mbi 100 000 deri në 1 milion llogari të qasura; plus
 - 1.4. 5% e pjesës së N mbi 1 milion deri në 10 milionë llogari të qasura; plus
 - 1.5. 0.025% e pjesës së N mbi 10 milionë llogari të qasura,
ku N është numri i llogarive të ndryshme të pagesave të qasura nga subjekti në 12 muajt e mëparshëm.
2. Për subjektet që nuk kanë ofruar shërbime të pagesave në asnjë moment gjatë 12 muajve të fundit, numri i llogarive të pagesave të qasura duhet të jetë numri i llogarive të pagesave të qasura të parashikuara nga subjekti për qëllimin e aplikimit të tij për licencë ose regjistrim, sipas rastit.
3. Për subjektet në vitin e parë të aktivitetit të tyre (pas marrjes së licencës/regjistrimit), të cilat nuk kanë përfunduar 1 vit të plotë kalendarik aktiviteti, numri i llogarive të pagesave të qasura duhet të bazohet në numrin e llogarive të qasura të pagesave të parashikuara nga subjekti për qëllimin e aplikimit të tij për licencë ose regjistrim, kur është e aplikueshme.
4. Nëse subjekti nuk jep asnjë parashikim në lidhje me numrin e llogarive të pagesave të qasura, ose nëse shuma që rezulton nga aplikimi i numrit të parashikuar të llogarive të pagesave të qasura është më pak se 50 000 (pesëdhjetë mijë), vlera për këtë tregues në formulë duhet të vendoset në 50 000 (pesëdhjetë mijë).

Nënkapitulli II

Llogaritja e shumës që pasqyron kriterin e llojit dhe madhësisë së aktivitetit

Neni 11

Llogaritja e shumës që pasqyron kriterin e llojit të aktivitetit

1. Subjektet që aplikojnë për licencë për të ofruar vetëm SHIP duhet ta vendosin vlerën për këtë tregues në formulë në 0.
2. Subjektet që aplikojnë për regjistrim për të ofruar vetëm SHILL duhet ta vendosin vlerën për këtë tregues në formulë në 0.
3. Nëse një subjekt aplikon për licencë për të ofruar si SHIP ashtu edhe SHILL, ai duhet ta llogarisë shumën minimale monetare veçmas për secilin shërbim dhe t'i shtojë shumat që rezultojnë për ta fituar shumën minimale monetare që i mbulon të dyja shërbimet. Në këtë rast, SPP ose garancitë e ngjashme që mbulojnë ofrimin e të dyja shërbimeve duhet t'i pasqyrojnë detyrimet e ndryshme të përmendura në nenin 8, paragrafët 2 dhe 3 të LSHP-së.
4. Nëse një subjekt ofron shërbime të tjera të pagesave, siç përmendet në nënparagrafët 1.2.1 deri në 1.2.6 të paragrafit 1 të nenit 4 të LSHP-së, paralelisht me SHIP ose SHILL ose të dyja, shuma minimale e SPP ose garancive të ngjashme për ofrimin e SHIP ose SHILL ose të dyjave duhet të llogaritet pa paragjykuar kërkesat për kapitalin fillestar dhe fondet vetanake të përcaktuara në nenet 9 dhe 10 të LSHP-së dhe rregulloret e zbatueshme të BQK-së.
5. Nëse një subjekt është i angazhuar edhe në aktivitete tjera biznesi të ndryshme nga ofrimi i shërbimeve të pagesave, ai duhet t'i shtojë formulës vlerën 50 000 krahas vlerave të kërkuara për llojin e aktivitetit që synon ta ofrojë.
6. Megjithatë, nëse një subjekt që është i angazhuar në aktivitete të tjera biznesi mund të demonstrojë se angazhimi i tij nuk ka ndikim në ofrimin e SHIP ose SHILL, qoftë për shkak se ka garanci që mbulon detyrimet e tij që rrjedhin nga aktivitetet e tjera të biznesit ose sepse BQK ka kërkuar themelimin e një subjekti të veçantë për biznesin e shërbimeve të pagesave në përputhje me nenin 14, paragrafi 5 i LSHP-së, subjekti duhet ta vendos vlerën e formulës në zero.

Neni 12

Llogaritja e shumës që pasqyron kriterin e madhësisë së aktivitetit

1. Subjektet që ofrojnë SHIP duhet ta llogarisin shumën që pasqyron kriterin e madhësisë së aktivitetit si shumë e elementeve të mëposhtme:
 - 1.1. 40% e pjesës së N deri në 500 000 euro; plus
 - 1.2. 25% e pjesës së N mbi 500 000 euro deri në 1 milion euro; plus
 - 1.3. 10% e pjesës së N mbi 1 milion euro deri në 5 milionë euro; plus
 - 1.4. 5% e pjesës së N mbi 5 milionë euro deri në 10 milionë euro; plus
 - 1.5. 0.025% e pjesës së N mbi 10 milionë euro,ku N është vlera totale e të gjitha transaksioneve të iniciuara nga subjekti në 12 muajt e mëparshëm.
2. Subjektet që ofrojnë SHILL duhet ta llogarisin shumën që pasqyron kriterin e madhësisë së aktivitetit si shumë e elementeve të mëposhtme:

- 2.1. 40% e pjesës së N deri në 100 përdorues; plus
- 2.2. 25% e pjesës së N mbi 100 përdorues deri në 10 000 përdorues; plus
- 2.3. 10% e pjesës së N mbi 10 000 përdorues deri në 100 000 përdorues; plus
- 2.4. 5% e pjesës së N mbi 100 000 përdorues deri në 1 milion përdorues; plus
- 2.5. 0.025% e pjesës së N mbi 1 milion përdorues.

ku N është numri i përdoruesve të SHILL, ku secili përdorues merret parasysh veçmas, të cilët kanë përdorur SHILL në 12 muajt e fundit.

3. Për subjektet që nuk kanë ofruar shërbime në 12 muajt e fundit, duhet të përdoret vlera e të gjitha transaksioneve të iniciuara për një OSHIP ose numri i klientëve për një OSHILL, siç është parashikuar nga subjekti për qëllime të licencimit ose regjistrimit të tij, sipas rastit.
4. Për subjektet në vitin e tyre të parë të operimit (sipas licencimit ose regjistrimit) që nuk kanë përfunduar një vit të plotë kalendarik operimi, duhet të përdoret vlera e të gjitha transaksioneve të iniciuara në rastin e një OSHIP, ose numri i klientëve në rastin e një OSHILL, siç është parashikuar nga subjekti në momentin e licencimit ose regjistrimit të tij.
5. Nëse subjekti nuk ofron parashikime për vlerën e të gjitha transaksioneve të iniciuara në rastin e një OSHIP ose numrin e klientëve në rastin e një OSHILL, ose nëse shuma që rezulton nga aplikimi i vlerës së parashikuar të të gjitha transaksioneve të iniciuara ose numri i klientëve është më pak se 50 000 (pesëdhjetë mijë), atëherë vlera e këtyre treguesve në formulë duhet të vendoset në 50 000 (pesëdhjetë mijë).

Neni 13

Kërkesat për dokumentacionin dhe kriteret

1. Nëse një SPP ose një garanci e ngjashme, sipas kushteve dhe e llogaritur siç përcaktohet në këtë nen, duhet të mbahet nga të gjitha subjektet që i nënshtrohen kësaj rregulloreje.
2. Si dëshmi e SPP ose garancisë së ngjashme, subjekti duhet t'i ofrojë BQK-së një kontratë sigurimi (policë) ose dokument të ngjashëm që konfirmon ekzistencën e sigurimit ose garancisë dhe specifikon detyrimet përkatëse të mbuluara nga sigurimi ose garancia.
3. SPP ose garancia e ngjashme duhet të lëshohet nga një kompani sigurimesh ose bankë e themeluar në Kosovë ose në ndonjë formë tjetër të pranuar nga BQK, e cila nuk është pjesë e të njëjtit grup si vetë subjekti.
4. Polica e sigurimit ose garancia e ngjashme do të paguhet në rast se subjekti nuk është në gjendje t'i përmbushë detyrimet e tij ndaj përdoruesve të shërbimit të pagesave dhe OSHPLL-ve në përputhje me nxitësit për zbatimin e tij.

Neni 14

Llogaritja periodike dhe raportimi në Bankën Qendrore të Kosovës

1. Të gjitha subjektet që i nënshtrohen kësaj rregulloreje do ta rillogaritin vlerën minimale monetare të SPP-ve të tyre ose të garancive të ngjashme të paktën çdo vit, brenda muajit janar të secilit vit, bazuar në të dhënat vjetore të vitit të kaluar kalendarik.

2. Subjektet duhet t'i raportojnë BQK-së deri në fund të muajit shkurt të secilit vit, duke i përdorur formularët e ofruar nga BQK në Shtojcën 1 të kësaj rregulloreje, komponentët dhe shumën minimale monetare të SPP të tyre ose garancive të ngjashme, të llogaritura në përputhje me formulat e përcaktuara në këtë rregullore.
3. Pas rillogaritjes së shumës minimale monetare të SPP ose garancive të ngjashme, subjektet duhet ta finalizojnë dhe nënshkruajnë kontratën e sigurimit ose garancisë për shumën e rillogaritur dhe ta njoftojnë BQK-në brenda 10 ditëve pune nga data e nënshkrimit të kontratës përkatëse.

Neni 15

Shtojca

Pjesë përbërëse e kësaj rregullore është Shtojca I Tabelat për llogaritjen e shumës minimale monetare të sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garancive të ngjashme.

KAPITULLI III DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 16

Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkimet

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje do t'i nënshtrohet masave korrigjuese dhe/ose ndëshkimeve administrative siç përcaktohet në nenin 67 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -150 dhe nenin 125 të Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga data e miratimit të saj.

Dr.sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

SHTOJCA 1

Tabelat për llogaritjen e shumës minimale monetare të sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garancive të ngjashme

Qëllimi i këtyre tabelave llogaritëse është t'i ndihmojnë subjektet në përcaktimin e shumës minimale monetare të sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garancive të tjera të ngjashme për ofrimin e shërbimeve të informacionit të llogarisë (SHILL) dhe/ose shërbimeve të inicimit të pagesave (SHIP), në përputhje me nenin 8 paragrafët 2 dhe 4 të Ligjit për Shërbimet e Pagesave dhe Rregullores për Kriteret për Përcaktimin e Shumës Minimale të Sigurimit të Përgjegjësisë Profesionale ose Garancive të tjera të Ngjashme.

Për subjektet që synojnë të ofrojnë (që aplikojnë për autorizim) vetëm shërbimin e inicimit të pagesave (SHIP)

Pyetjet fillestare	
A ofron/synon të ofrojë ndërmarrja vetëm SHIP, vetëm SHILL, apo të dyja SHIP dhe SHILL?	
A ka ofruar ndërmarrja shërbime në 12 muajt e mëparshëm?	
A ka dhënë ndërmarrja ndonjë vlerë të parashikuar për ofrimin e shërbimeve?	
A angazhohet ndërmarrja në biznes tjetër përveç ofrimit të shërbimeve të pagesave?	
A ka ndërmarrja garanci që mbulon detyrimet e saj që rrjedhin nga aktivitete të tjera të biznesit?	

Sigurimi i përgjegjësisë profesionale ose garancia e ngjashme për ndërmarrjet që ofrojnë/synojnë të ofrojnë vetëm SHIP		
Referenca në rregullore	Treguesi	Vlera vjetore
8.3, 8.4 dhe 8.5	Vlera e parashikuar e kërkesave për rimbursim (EUR/12 muaj)	
9.2, 9.3 dhe 9.4	Numri i parashikuar i transaksioneve të pagesave të iniciuara (njësi/12 muaj)	
11.5 dhe 11.6	Angazhimi në biznes tjetër përveç ofrimit të shërbimeve të pagesave	
12.3, 12.4 dhe 12.5	Vlera e parashikuar e transaksioneve të pagesave të iniciuara (EUR/12 muaj)	

Shuma minimale monetare e sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garancisë së ngjashme (EUR)		
Formula*		Vlera vjetore
(+) Shuma që pasqyron kriterin e profilit të rrezikut		
(+) Shuma që pasqyron kriterin e llojit të aktivitetit		
(+) Shuma që pasqyron kriterin e madhësisë së aktivitetit		

(=) Shuma minimale monetare e sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garancisë së ngjashme (EUR)	
---	--

Data e llogaritjes	
Periudha e referencës (12 muaj)	

Shënim: SHIP nënkupton shërbimin e inicimit të pagesave dhe SHILL nënkupton shërbimin e informacionit të llogarisë.

Për subjektet që ofrojnë (që janë të autorizuar të ofrojnë) vetëm shërbimin e inicimit të pagesës (SHIP)

Pyetjet fillestare	
A ofron/synon të ofrojë ndërmarrja vetëm SHIP, vetëm SHILL, apo të dyja SHIP dhe SHILL?	
A ka ofruar ndërmarrja shërbime në 12 muajt e mëparshëm?	
A angazhohet ndërmarrja në biznes tjetër përveç ofrimit të shërbimeve të pagesave?	
A ka ndërmarrja garanci që mbulon detyrimet e saj që rrjedhin nga aktivitete të tjera të biznesit?	

Sigurimi i përgjegjësisë profesionale ose garancia e ngjashme për ndërmarrjet që ofrojnë/synojnë të ofrojnë vetëm SHIP		
Referenca në rregullore	Treguesi	Vlera vjetore
8.1 dhe 8.2	Vlera e të gjitha kërkesave për rimbursimet e marra (EUR/12 muajt e mëparshëm)	
9.1	Numri i transaksioneve të pagesave të iniciuara (njësi/12 muajt e mëparshëm)	
11.5 dhe 11.6	Angazhimi në biznes tjetër përveç ofrimit të shërbimeve të pagesave	
12.1	Vlera e transaksioneve të pagesave të iniciuara (EUR/12 muajt e mëparshëm)	

Shuma minimale monetare e sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garancisë së ngjashme (EUR)		
Formula*		Vlera vjetore
(+) Shuma që pasqyron kriterin e profilit të rrezikut		
(+) Shuma që pasqyron kriterin e llojit të aktivitetit		
(+) Shuma që pasqyron kriterin e madhësisë së aktivitetit		
(=) Shuma minimale monetare e sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garancisë së ngjashme (EUR)		

Data e llogaritjes	
Periudha e referencës (12 muaj)	

Shënim: SHIP nënkupton shërbimin e inicimit të pagesave dhe SHILL nënkupton shërbimin e informacionit të llogarisë.

Për subjektet që synojnë të ofrojnë (që aplikojnë për regjistrim) vetëm shërbimin e informacionit të llogarisë (SHILL)

Pyetjet fillestare	
A ofron/synon të ofrojë ndërmarrja vetëm SHIP, vetëm SHILL, apo të dyja SHIP dhe SHILL?	
A ka ofruar ndërmarrja shërbime në 12 muajt e mëparshëm?	
A ka dhënë ndërmarrja ndonjë vlerë të parashikuar për ofrimin e shërbimeve?	
A angazhohet ndërmarrja në biznes tjetër përveç ofrimit të shërbimeve të pagesave?	
A ka ndërmarrja garanci që mbulon detyrimet e saj që rrjedhin nga aktivitete të tjera të biznesit?	

Sigurimi i përgjegjësisë profesionale ose garancia e ngjashme për ndërmarrjet që ofrojnë/synojnë të ofrojnë vetëm SHILL		
Referenca në rregullore	Treguesi	Vlera vjetore
8.3, 8.4 dhe 8.5	Vlera e parashikuar e kërkesave për rimbursim (EUR/12 muaj)	
10.2, 10.3 dhe 10.4	Numri i parashikuar i llogarive të pagesave të qasura (njësi/12 muaj)	
11.5 dhe 11.6	Angazhimi në biznes tjetër përveç ofrimit të shërbimeve të pagesave	
12.3, 12.4 dhe 12.5	Numri i parashikuar i përdoruesve të SHILL (klientë/12 muaj)	

Shuma minimale monetare e sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garancisë së ngjashme (EUR)		
Formula*		Vlera vjetore
(+) Shuma që pasqyron kriterin e profilit të rrezikut		
(+) Shuma që pasqyron kriterin e llojit të aktivitetit		
(+) Shuma që pasqyron kriterin e madhësisë së aktivitetit		
(=) Shuma minimale monetare e sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garancisë së ngjashme (EUR)		

Data e llogaritjes	
Periudha e referencës (12 muaj)	

Shënim: SHIP nënkupton shërbimin e inicimit të pagesave dhe SHILL nënkupton shërbimin e informacionit të llogarisë.

Për subjektet që ofrojnë (që janë regjistruar për të ofruar) vetëm shërbimin e informacionit të llogarisë (SHILL)

Pyetjet fillestare	
A ofron/synon të ofrojë ndërmarrja vetëm SHIP, vetëm SHILL, apo të dyja SHIP dhe SHILL?	
A ka ofruar ndërmarrja shërbime në 12 muajt e mëparshëm?	
A angazhohet ndërmarrja në biznes tjetër përveç ofrimit të shërbimeve të pagesave?	
A ka ndërmarrja garanci që mbulon detyrimet e saj që rrjedhin nga aktivitete të tjera biznesi?	

Sigurimi i përgjegjësisë profesionale ose garancia e ngjashme për ndërmarrjet që ofrojnë/synojnë të ofrojnë vetëm SHILL		
Referenca në rregullore	Treguesi	Vlera vjetore
8.1 dhe 8.2	Vlera e të gjitha kërkesave për rimbursime të marra (EUR/12 muajt e mëparshëm)	
10.1	Numri i llogarive të pagesave të qasura (njësi/12 muajt e mëparshëm)	
11.5 dhe 11.6	Angazhimi në biznes tjetër përveç ofrimit të shërbimeve të pagesave	
12.2	Numri i përdoruesve të SHILL (klientët/12 muajt e mëparshëm)	

Shuma minimale monetare e sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garancisë së ngjashme (EUR)		
Formula*		Vlera vjetore
(+) Shuma që pasqyron kriterin e profilit të rrezikut		
(+) Shuma që pasqyron kriterin e llojit të aktivitetit		
(+) Shuma që pasqyron kriterin e madhësisë së aktivitetit		
(=) Shuma minimale monetare e sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garancisë së ngjashme (EUR)		

Data e llogaritjes	
Periudha e referencës (12 muaj)	

Shënim: SHIP nënkupton shërbimin e inicimit të pagesave dhe SHILL nënkupton shërbimin e informacionit të llogarisë.

Për subjektet që synojnë të ofrojnë (që aplikojnë për autorizim) për ofrimin e shërbimit të inicimit të pagesës dhe shërbimit të informacionit të llogarisë (SHIP dhe SHILL)

Pyetjet fillestare	
A ofron/synon të ofrojë ndërmarrja vetëm SHIP, vetëm SHILL, apo të dyja SHIP dhe SHILL?	
A ka ofruar ndërmarrja shërbime në 12 muajt e mëparshëm?	
A ka dhënë ndërmarrja ndonjë vlerë të parashikuar për ofrimin e shërbimeve?	
A angazhohet ndërmarrja në biznes tjetër përveç ofrimit të shërbimeve të pagesave?	
A ka ndërmarrja garanci që mbulon detyrimet e saj që rrjedhin nga aktivitete të tjera të biznesit?	

Sigurimi i përgjegjësisë profesionale ose garancia e ngjashme për ndërmarrjet që ofrojnë/synojnë të ofrojnë vetëm SHIP dhe SHILL		
Referenca në rregullore	Treguesi	Vlera vjetore
11.5 dhe 11.6	Angazhimi në biznes tjetër përveç ofrimit të shërbimeve të pagesave	
8.3, 8.4 dhe 8.5	Vlera e parashikuar e kërkesave për rimbursim për SHIP dhe SHILL (EUR/12 muaj)	
	Llogaritja e SHIP	
9.2, 9.3 dhe 9.4	Numri i parashikuar i transaksioneve të pagesave të iniciuara (njësi/12 muaj)	
12.3, 12.4 dhe 12.5	Vlera e parashikuar e transaksioneve të pagesave të iniciuara (EUR/12 muaj)	
	Llogaritja e SHILL	
10.2, 10.3 dhe 10.4	Numri i parashikuar i llogarive të pagesave të qasura (njësi/12 muaj)	
12.3, 12.4 dhe 12.5	Numri i parashikuar i përdoruesve të SHILL (klientë/12 muaj)	

Shuma minimale monetare e sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garancisë së ngjashme (EUR)		
Formula*		Vlera vjetore
(+) Shuma që pasqyron kriterin e profilit të rrezikut		
(+) Shuma që pasqyron kriterin e llojit të aktivitetit		
(+) Shuma që pasqyron kriterin e madhësisë së aktivitetit		
(=) Shuma minimale monetare e sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garancisë së ngjashme (EUR)		

Data e llogaritjes	
Periudha e referencës (12 muaj)	

Shënim: SHIP nënkupton shërbimin e inicimit të pagesave dhe SHILL nënkupton shërbimin e informacionit të llogarisë.

Për subjektet që ofrojnë (që janë të autorizuar të ofrojnë) shërbimin e inicimit të pagesës dhe shërbimin e informacionit të llogarisë (SHIP dhe SHILL)

Pyetjet fillestare	
A ofron/synon të ofrojë ndërmarrja vetëm SHIP, vetëm SHILL, apo të dyja SHIP dhe SHILL?	
A ka ofruar ndërmarrja shërbime në 12 muajt e mëparshëm?	
A angazhohet ndërmarrja në biznes tjetër përveç ofrimit të shërbimeve të pagesave?	
A ka ndërmarrja garanci që mbulon detyrimet e saj që rrjedhin nga aktivitete të tjera të biznesit?	

Sigurimi i përgjegjësisë profesionale ose garancia e ngjashme për ndërmarrjet që ofrojnë/synojnë të ofrojnë vetëm SHIP dhe SHILL		
Referenca në rregullore	Treguesi	Vlera vjetore
11.5 dhe 11.6	Angazhimi në biznes tjetër përveç ofrimit të shërbimeve të pagesave	
8.1 dhe 8.2	Vlera e të gjitha kërkesave për rimbursime të marra për SHIP dhe SHILL (EUR/12 muajt e mëparshëm)	
	Llogaritja e SHIP	
9.1	Numri i transaksioneve të pagesave të iniciuara (njësi/12 muajt e mëparshëm)	
12.1	Vlera e transaksioneve të pagesave të iniciuara (EUR/12 muajt e mëparshëm)	
	Llogaritja e SHILL	
10.1	Numri i llogarive të pagesave të qasura (njësi/12 muajt e mëparshëm)	
12.2	Numri i përdoruesve të SHILL (klientët/12 muajt e mëparshëm)	

Shuma minimale monetare e sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garancisë së ngjashme (EUR)		
Formula*		Vlera vjetore
(+) Shuma që pasqyron kriterin e profilit të rrezikut		
(+) Shuma që pasqyron kriterin e llojit të aktivitetit		
(+) Shuma që pasqyron kriterin e madhësisë së aktivitetit		
(=) Shuma minimale monetare e sigurimit të përgjegjësisë profesionale ose garancisë së ngjashme (EUR)		

Data e llogaritjes	
Periudha e referencës (12 muaj)	

Shënim: SHIP nënkupton shërbimin e inicimit të pagesave dhe SHILL nënkupton shërbimin e informacionit të llogarisë.